

VENDIM
Nr. 2, datë 7.1.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK LUSHNJË QYTET

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe Metodologjisë mbi vendosjen e tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratojë për sh.a. UK Lushnjë tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë

	Tarifa fikse lekë/muaj/klient	Tarifë volumetrike lekë/m ³
Konsumator familjar (me dhe pa matës)	100	52
Institucione buxhetore	200	120
Ente private	200	130

b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura

Konsumator familjar	-	14
Institucione buxhetore	-	18
Ente private	-	20

Shitje uji me shumicë

32

2. Objektivat e treguesve të performancës të shoqërisë për vitin 2013

- uji pa të ardhura (humbjet)	60%
- niveli i matjes	90%
- kohëzgjatja e furnizimit	8 orë/ditë
- efienca e energjisë	0.6 kwh/ m ³
- efikasiteti i stafit	5.7 staf/000 lidhje
- mbulimi me ujë	85%
- mbulimi me kanalizime	72%
- norma e arkëtimit	90%
- cilësia e ujit (klor+koliform)	100% norma e sigurisë

3. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Lushnjë do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi